



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË**

Korçë, më datë 01/12/2022

Proces-verbal

Bazuar në ligjin nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 22 nëntor 2022 dhe 24 nëntor 2022 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të banorëve, u zhvilluan takime me banorët e Rajonit 1 dhe 2 të qytetit të Korçës.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Kletjon Kita Zv.Kryetar Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Leonard Gjançi Drejtor i Menaxhimit të Kontratave, Soniel Prifti Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara dhe në proces në qytetin e Korçës. Mes tyre përmendi investimet e kryera për termoizolim të pallateve, punën e shkëlqyer që është bërë për ujësjellësin dhe kanalizimet, si edhe për asfaltimin e rrugëve në lagje të ndryshme të qytetit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar Qendrës së Teknologjisë dhe Inovacionit, e cila është një mundësi e mirë punësimi për të rinjtë dhe të rejtat e qytetit si edhe ndërtimi i një parku Fotovoltaik një investim shumë i rëndësishëm që do të realizohet në të ardhmen për përmirësimin e furnizimit me energji. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të qytetarëve dhe vendosjen e prioriteteve për investimet pasi impakti i parë i çdo projekti perceptohet prej tyre.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje”, qytetarët e Korçës patën hapësirën e nevojshme kohore për të ngritur kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçe për vitin 2023. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara. Bazuar në kërkesat e ngritura nga qytetarët u listuan prioritetet si më poshtë:

1. Asfaltimi i disa rrugëve brenda zonave të banimit
2. Sistemimi i kanalizimeve të ujërat e zezat në lagjen 3
3. Përmirësimi i infrastrukturës së këndeve të lojërave për fëmijë
4. Meremetimi i disa pallateve ekzistuese

XXX: Banor, lagjja 10: Tek zona e entit të banesave është e gjithë rruga e bllokuar dhe nuk mund të kalojnë mjetet për shkak se në atë zonë janë hedhur inerte të cilat duhet të pastrohen. Është një problem shqetësues sepse mund të jetë edhe burim aksidentesh. Gjithashtu stacionet e autobusëve në këtë lagje janë të dëmtuara, ju lutem t’i shikoni dhe sistemoni sa më parë.

XXX: Banor, lagjja 3: Kërkojmë zgjidhje për kanalizimin e ujërave të zeza. Po afron dimri dhe gjatë kësaj stine çdo gjë bëhet më e vështirë për të gjithë banorët. Kjo lagje ka nevojë edhe për investime të tjera por kanalizimet mbeten problematika kryesore. Jam i sigurt se do t’i gjeni një zgjidhje sa më parë problematikës sonë. Ju urojmë punë të mbarë në vazhdim dhe faleminderit që na bëni pjesë të këtyre takimeve.

XXX: Banor, lagjja 2: Ju falenderojmë që na bëni pjesë të këtyre takimeve. Është shumë e rëndësishme të ndajmë së bashku ato shqetësime që kemi në lidhje me zonën ose lagjen ku banojmë. Problemi që dua të ngre ka të bëjë me shkollën “Ymer Dishnica”. Është një shkollë që ka shumë problematika duke filluar që nga ndërtesa, oborri i jashtëm, si dhe koshat e mbeturinave që ndodhen në oborr, të cilat duhet të ndërrohen më shpesh. Një problematikë tjetër është këndi i lojërave tek parku “Rinia” duhet të zgjerohet më shumë. Janë shumë fëmijë që luajnë dhe argëtohen aty çdo ditë, ndaj mendojmë se do të ishte më mirë që të zgjerohej me më shumë hapësirë dhe lojëra të reja.

XXX: Banor, lagjja 4: Keni bërë një punë shumë të mirë për asfaltimin e rrugëve në shumë lagje të qytetit. Ne si banorë të lagjes 4 ngremë një shqetësim për asfaltimin e rrugës që ndodhet prapa shkollës “Nuçi Naçi”. Janë asfaltuar edhe rrugë të tjera në lagjen 4 por kjo jo. Ju lutem shikojeni me përparësi problematikën tonë. Faleminderit!

XXX: Banor, lagjja 5: Kemi një shqetësim në lidhje me rrugën “Rexhep Telhaj”, është një zonë që sa herë ka reshje përmytet. Mbase mund të ketë ndonjë problem në lidhje me kanalizimet, duhet të dërgoni dikë që të shikojë zonën. Gjithashtu një problematikë tjetër ka të bëjë me asfaltimin e rrugës mbrapa Radio Korçës, është rreth 500 m rrugë që ka nevojë për asfaltim.

XXX: Banor, lagjja 15: Duhet të fillojë puna për rregullimin e trotuarëve në rrugën “Viktor Eftimiu”. Gjithashtu një problem tjetër janë edhe këndet e lojërave për fëmijë, të cilat duhet të përmirësohen kudo në qytet, duhet të zëvendësohen lodrat e vjetra me të reja si edhe duhet të shikohet mundësia për ndonjë sistemim.

XXX: Kemi parë se në disa lagje të qytetit po bëni një punë shumë të mirë për meremetimin e suvasë së disa pallateve ekzistues. Edhe pallati 25 në lagjen “Viktor Eftimiu” ka nevojë për një rregullim suvaje sepse është shumë e dëmtuar.

Konceptoi

Lorena Saro

**Drejtores e Marrëdhënieve me Publikun
dhe Informimin Qytetar**

Larisa Katundi

Rajoni Nr.1



Rajoni Nr.2

